



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. 15156 Prot

Shkodër, më 19/10.2023

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendimi dhe relacioni.

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar Këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin:

“Për dhënien në përdorim, pa kundërshpërblim të një sipërfaqe prej 602 m²(kati parë) dhe 602 m²(kati dytë) objekti “ish Konvikti Safet Spahiu”, në favor të Shoqërisë Rajonale Ujës-jellës Kanalizime Qarku Shkodër, shoqëri aksionare me ofertë publike, me qëllim vazhdimin e ofrimit të shërbimeve rajonale dhe vendore për qytetarët e Qarkut të Shkodrës”.

Duke ju uruar punë të mbarë!

Me respekt,



KRYETAR

Benet BECI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETARI

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2023

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, datë _____.____.2023

“PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA KUNDËRSHPËRBLIM TË NJË SIPËRFAQE PREJ 602 M² (KATI PARË) DHE 602 M² (KATI DYTË) OBJEKTI “ISH KONVIKTI SAFET SPAHIU”, NË FAVOR TË SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME QARKU SHKODËR, SHOQËRI AKSIONARE ME OFERTË PUBLIKE, ME QËLLIM VAZHDIMIN E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE RAJONALE DHE VENDORE PËR QYTETARËT E QARKUT TË SHKODRËS”.

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës _____.____.2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të ligjit nr.7850 dt.28.7.1994 “Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 9 pika 1.2, germa a), nenit 54, germa e/1), të ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” të ndryshuar, VKM nr.421, datë 02.06.2010 “Për Miratimin e listës përfundimtare (të Pjesshme) të Pronave të Paluajtshme Publike, Shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Shkodër, të Qarkut të Shkodrës” të ndryshuar, VKM nr. 302, datë 11.5.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, VKB nr.38, datë 26.7.2022 “Për pjesëmarrjen e bashkisë Shkodër në subjekte me kompetenca të përbashkëta me qëllim kryerjen e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura”, vërtetim nga dokumenti hipotekor me nr.479, datë 19.12.2013, pas shqyrtimit të relacionit nr. _____.prot, datë _____ të administratës së bashkisë Shkodër ;

VENDOSI:

1. Të miratoj dhënie në përdorim pa kundërshtim, për një periudhë 10 (vjeçare) vjeçare, të sipërfaqes prej 602 m²(gjashtëqind e dy), kati parë dhe 602 m² (gjashtëqind e dy), kati dytë pronë e Bashkisë Shkodër, e regjistruar në regjistrin hipotekor numër 479, datë 19.12.2013, me numër pasurie 4/49, në zonën kadastrale 8594, në favor të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Qarku Shkodër, shoqëri aksionare me ofertë publike, sipas planimetrive bashkëlidhur.
2. Qëllimi i përdorimit të kësaj sipërfaqe do të jetë ushtrimi funksional i shërbimeve administrative nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Qarku Shkodër, ku Bashkia Shkodër është aksionare me kuotat 36.33% të Aksioneve të Shoqërisë.

3. Dhënia në përdorim e pasurisë së sipërcituar do të realizohet përmes një kontrate huapërdorje, ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Qarku Shkodër.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Benet BECI



Z/Kryetar

**Drejtorja e Burimeve Njerëzore
dhe Burimeve Mbështetëse**

Drejtorja Juridike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.2023

RELACION

“PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA KUNDËRSHPËRBLIM TË NJË SIPËRFAQE PREJ 602 M² (KATI PARË) DHE 602 M² (KATI DYTË) OBJEKTI “ISH KONVIKTI SAFET SPAHIU”, NË FAVOR TË SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME QARKU SHKODËR, SHOQËRI AKSIONARE ME OFERTË PUBLIKE, ME QËLLIM VAZHDIMIN E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE RAJONALE DHE VENDORE PËR QYTETARËT E QARKUT TË SHKODRËS”.

Drejtuar: Këshillit Bashkiak, Shkodër.

Të nderuar këshilltarë!

Referuar kërkeses së paraqitur dhe në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet bashkisë Shkodër dhe shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Qarku Shkodër, shoqëri aksionare me ofertë publike, si dhe detyrimeve ligjore me qëllim vazhdimin e ofrimit të shërbimeve rajonale dhe vendore për qytetarët e Qarkut të Shkodrës, sipas objektit të veprimtarisë të shoqërisë me nr.NIPTI (NUIS) M37819701O, paraqesim për miratim projekt vendimin “Për dhënie në përdorim, pa kundërshtëpërblim të një sipërfaqe prej 602 m² (kati parë) dhe 602 m² (kati dytë) objekti “ish konvikti Safet Spahiu”, me numer pasurie 4/49, ndodhur në ZK 8594, në favor të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Qarku Shkodër.

Bashkia Shkodër referuar VKM nr.302, datë 11.05.2022 “Per Politikat Kombetare per Riorganizimin e Sektorit te Furnizimit me Uje dhe te Largimit ,Trajtimit dhe Punimit te Ujrave te Ndotura” nepërmjet Vendimit te Keshillit Bashkiak nr.38 date 26.07.2022 “Per pjesëmarrjen e Bashkisë Shkodër në subjekte me kompetenca te perbashketa me qellim kryerjen e shërbimeve te furnizimit me uje te pijshem , grumbullimit ,largimit dhe trajtimit te ujrave te ndotura”, ka vendosur të jetë pjesë dhe bashkëpronare në aksionet e kësaj Shoqërie .

Aktualisht referuar akteve ligjore dhe nënligjore ne fuqi në Republikën e Shqipërisë, ofrimi i shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve (banorëve të bashkisë Shkodër dhe qarkut Shkodër), mirëmbajtja e sistemeve të furnizimit me ujë, prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve, shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre realizohet nepërmjet Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Qarku Shkodër, shoqëri aksionare me ofertë publike me nr. NIPTI (NUIS) M37819701O, me

aksionar Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës në masën 51% ; Bashkia Shkodër në masën 36,33% dhe pjesa tjetër e shpërndarë ndërmjet bashkive të tjera të Qarkut Shkodër .

Në kushtet ku Ujesjelles Kanalizime Sh.a , nuk është më SH.A me kapital 100% të vetin por Bashkia Shkoder aktualisht rezulton pronar me 36.33 % te aksioneve në këtë SH.A dhe me kushtezimet e përcaktuara në VKM 1163 date 13.08.2008 , pika 3 , gjendemi në kushtet e risistemimit me zyrë/ambiente për ushtrimin e aktivitetit të saj.

Propozimi jonë në këshillin bashkiak vjen edhe si rezultat i kërkesës së paraqitur nga ana e administratorit të SH.A-së , nepërmjet kërkesës me objekt “Mbi mundesine e dhenies ne perdorim te ambienteve te lira”.

Pas verifikimeve të aseteve tona , rezulton të kemi mundësinë të vendosim në dispozicion objektin me sipërfaqe prej 602 m² (gjashtëqind e dy), kati parë dhe 602 m² (gjashtëqind e dy), kati dytë në godinën e “ish Konvikti Safet Spahiu” pronë e Bashkisë së Shkodrës, e regjistruar në regjistrin hipotekor me numër 479, datë 19.12.2013, me numër pasurie 4/49, në zonën kadastrale 8594, sipas planimetrive bashkangjitur.

Pasuria është e transferuar në favor të Bashkise Shkodër sipas VKM Nr. 421, datë 2.6.2010 "Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të Qarkut të Shkodrës ", të ndryshuar , sipas formularit te inventarizimit nr.6.

Ky objekt sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak me nr.9, datë 26.02.2020 ka ndryshuar fushën e përdorimit dhe saktësimin e të dhënave nga përdorimi paraardhës me fushë “Arsimi” në fushë përdorim “Administrative, Shendeti Publik”. Për këtë vendim të Këshillit bashkiak është marrë ligjshmeria nga Prefekti i Qarkut Shkoder, sipas shkreses me nr.202/1 prot datë 12.03.2020.

Bashkia Shkoder propozon dhënien në përdorim pa kundërshpërblim të objektit si më sipër, me afat 10 (dhjete) vjeçar dhe me kusht te investimit nga kjo shoqëri në rikonstruksionin e plotë të të gjithë ambienteve, sipas planimetrive bashkangjitur.

Proçedura e investimit shoqërohet me preventivat përkatës (tekniko-financiar) si dhe duke marrë miratimin për secilën fazë në Bashkinë Shkodër. I gjithë insvestimi i kryer në përfundim të kontratës mbëtet aset i bashkisë Shkodër .

Vlerësojmë se ky propozim për “*dhënien në përdorim, pa kundërshpërblim të një sipërfaqe prej 602 m² (kati parë) dhe 602 m² (kati dytë) objekti “ish konvikti safet spahiu”, në favor të shoqërisë rajonale ujësjellës kanalizime qarku Shkodër, shoqëri aksionare me ofertë publike, me qëllim vazhdimin e ofrimit të shërbimeve rajonale dhe vendore për qytetarët e qarkut të Shkodrës”, me funksion shërbimin me interes publik, gjen mbështetje ligjore në dispozitat e Kodit Civil; nenit 9 pika 1.2, germa a), nenit 54, germa e/1), të ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; VKM nr.421, datë 02.06.2010 ”Për Miratimin e listës përfundimtare (të Pjesshme) të Pronave të Paluajtshme Publike, Shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Shkodër, të Qarkut të Shkodrës” të ndryshuar, VKM nr. 302, datë 11.5.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit*

të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, VKB nr.38, datë 26.7.2022 “Për pjesëmarrjen e bashkisë Shkodër në subjekte me kompetenca të përbashkëta me qëllim kryerjen e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura”, vërtetim nga dokumenti hipotekor me nr.479, datë 19.12.2013.

Sa më sipër, i propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë dhënien në përdorim, pa kundërshtim të një sipërfaqe prej 602 m² (kati parë) dhe 602 m² (kati dytë) objekti “ish konvikti safet spahiu”, me nr.pasurie 4/49, ndodhur në ZK 8594 në favor të Shoqërisë Rajonale Ujësjetës Kanalizime Qarku Shkodër, shoqëri aksionare me ofertë publike, me qëllim vazhdimin e ofrimit të shërbimeve rajonale dhe vendqre për qytetarët e qarkut të Shkodrës”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin !



Drejtoria Juridike

The image shows several handwritten signatures in blue ink, likely belonging to members of the legal department. The signatures are written over a horizontal line. One signature is particularly large and stylized, while others are smaller and more legible.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E RREGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME
RRETHI SHKODER

VERTETIM
NGA DOKUMENTI HIPOTEKOR

Vertetohet se ne regjistrin hipotekor me nr. 479
 Datë 19/12/2013, figuron e regjistruar ne pronesi te:

Emri	Atesia	Mbiemri	Pjesa
<u>L. DASHKIA</u>	<u>SHKODER</u>		<u>1</u>

Pasuria me nr. 4/49 e ndodhur ne Zonen Kadastrale 8594 me
 Siperfaqe 602 m², ne adresen:

67 ASUTER QIND E DY) M² TRUALL NGA FASILAT 602 M² (67 ASUTER QIND E DY) M² TRUALL NGA FASILAT 602 M²

Kufizimet e pasurise jane:

V 4/49, L 4/49
 J 4/49, P 4/49

Origjina e regjistrimit te pasurise se paluajtshme:

Nr. hip. _____, date: ____/____/____, nr. hip. _____, date: ____/____/____
 Nr. hip. _____, date: ____/____/____, nr. hip. _____, date: ____/____/____
 Nr. hip. _____, date: ____/____/____, nr. hip. _____, date: ____/____/____

Barre mbi pasurine: NUK KA

Komente nga regjistruesi: REGJISTRIM

Ky vertetim eshte i vlefshem i shoqeruar me Harte Treguese Provizore

Zyra e Regjistrimit nuk garanton vertetimin e
 pronesise perpara perfundimit te Regjistrimit
 Fillestar sipas ligjit Nr. 33, date 21.03.2012

Vertetimi i pronesise leshohet sipas
 kerkeses Nr. 9883
 Date 02/12/2013 paraqitur ne ZRPP

JUREST: ANTON NJOSI

Date: 19/12/2013

REGJISTRUESI

ORESTI GJUCAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

SHKODËR
SEKRETARIA

Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike

Nr. 417 prot.

Tiranë, më 25/6 /2010

Lënda: Dërgim vendimi.

Drejtuar :
BASHKISË SHKODËR

SHKODËR

Dërgohet kopja e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.421, datë 2.06.2010 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Shkodër, të qarkut të Shkodrës", së bashku me listën e inventarit të pronave.

Ky vendim do të shërbejë për kryerjen e të gjitha procedurave të tjera, të cilat lidhen me regjistrimin e pronave në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

KRYETARË

Dhurata ÇUPI

[Signature]

ENDITIME, UDHËZIME, SHKRESA, KERKESA
2053 DATE 25/6/2010

OSIA E TITULLARIT:

VENDIME, UDHEZIME, SHKRESA, KERKESA
NR. 1892 DATE 11.06.10
DERGUAR NGA:
LEND A:



REPUBLIKA E SHKODËRISË TITULLARIT:
Këshilli i Ministrave



V E N D I M

Nr. 421 , datë 2.6.2010

PËR

MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE (TË PJESSHME)
TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE,
QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM
TË BASHKISË SHKODËR, TË QARKUT TË SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës përfundimtare (të pjeshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Shkodër, të qarkut të Shkodrës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 196 (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 855 (tetëqind e pesëdhjetë e pesë).

2. Ngarkohen ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".



KRYEMINISTRI

SALI BERISHA

MINISTRI I BRENDSHËM

LUEZIM BASHA

Numri rendor i pronës në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
7,13-19,21-23	Prona që përdoren në fushën administrative.	Në pronësi
32-73,851,852,853,	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
78-86,90-95,854	Prona që përdoren në fushën e shëndetit publik(shërbim parësor).	Në pronësi
216,218-225 (pjesa e paprivatizuar e 225),228-234,	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore.	Në pronësi
241-248,	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social.	Në pronësi
107-109,121-135,173-205,	Zhvillim ekonomik	Në pronësi
330-403,	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile.	Në pronësi
621-631	Prona që përdoren në fushën e ndriçimit publik.	Në pronësi
619-620,	Infrastruktura vendore	Në pronësi
578,579,	Shërbim funeral	Në pronësi

MINISTRI

LULZIM BASHA
Në mungesë dhe me porosi
ZËVENDËSMINISTRI

[Signature]
LULZIM BASHA


NR.PROT.2103/1
DATË 9.6.2010



MINISTRISË SË BRENDSHME
MINISTRISË SË FINANCAVE
MINISTRISË SË DREJTËSISË
MINISTRISË SË MBROJTJES
MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS
MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE
TRANSPORTIT
MINISTRISË SË PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE
SHANSEVE TË BARABARTA
MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRISË SË BUJQËSISË, USHQIMIT DHE
MBROJTJES SË KONSUMATORIT
MINISTRISË SË TURIZMIT, KULTURËS, RINISË
DHE SPORTEVE
BASHKISË SË SHKODRËS
KËSHILLIT TË QARKUT TË SHKODRËS
AGJENCISË SË KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË
PRONAVE
ZYRËS QENDRORE TË REGJISTRIMIT TË
PASURJVE
QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

Gjergj LEZHNA

Sekretar i Përgjithshëm



1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Identifikoi: **Ndret Qehaja Specialiste topograte**


(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Supervizori: **Kujtim Domnori Specialist inxhinier**

(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovot: **Artan Haxhi Kryetar Bashkie Tel 02243720**

(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)



Shkua SHKODER

Emri dhe adresat e pronave: ARSIMI

Nr. rrethit	A			B			C			
	Zona Kadastr. & Indeksi Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdores Statusi juridik i perdores	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
2		3	4	5	6	7	8	9	10	11
8	8593 I-7	7/459	Nd. Truell	Ish Shkolla Mekanike Bujqesore sot Shkolla " Turgut Ozal"	4148	1291	Arsimi Parauniversitar	Ministria Arsimit	Drejtoria Arsimore	Dhane me qera per 20 vjet
9	8591 N-6	3/26	Nd Truell	Shkolla Pedagogjike	4557	1684	Arsimi Parauniversitar	Ministria Arsimit	Drejtoria Arsimore	
0	8592 L-10	8/18 8/19 8/20	Nd Truell	Konvikti I Shkolles Pyjore	2826	792	Arsimi Parauniversitar	Ministria Arsimit	Drejtoria Arsimore	
1	8594 N-8	4/49	Nd. Truell	Konvikti "Safet Spahiu "	602	602	Arsimi Parauniversitar	Ministria e Arsimit	Drejtoria Arsimore	
2	8594 P-6	8/128	Nd. Truell	Konvikti I shkolles se Ndremit	1163	1163	Arsimi Parauniversitar	Ministria e Arsimit	Drejtoria Arsimore	
3	8591 H-5 I-5	12/32 12/33 12/34	Nd. Truell	Konvikti I shkolles Veterinare	742	742	Arsimi Parauniversitar	Ministria e Arsimit	Drejtoria Arsimore	I ZENE FORCERISHT

EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI AKSIONARE”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	M378197010			
2. Data e Regjistrimit	19/04/2023			
3. Emri i Subjektit	SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME QARKU SHKODËR SH.A			
4. Forma ligjore	SHA me ofertë publike			
5. Data e themelimit	05/04/2023			
6. Kohëzgjatja	Nga: 05/04/2023 Deri:			
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Shkoder Koplík Malësi e Madhe, Linaj- Gruemirë Rezervuari 4000m3.			
8. Kapitali	38.680.000,00			
9. Vlera e kapitalit të shlyer:	12600000.0000			
10. Numri i aksioneve:	386.800,00			
10.1 Vlera nominale:	100,00			
11. Kategoritë e aksioneve të shoqërisë	të zakonshme	me përparësi	me të drejte vote	pa të drejte vote
11.1 Numri për secilën kategori	386800			
12. Objekti i aktivitetit:	a) Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij; b) Mirëmbajtja e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm; c) Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkësës së konsumatorëve; d) Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura; e) Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre. 2. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.			
13. Sistemi i administrimit	<input type="checkbox"/> me një nivel <input checked="" type="checkbox"/> me dy nivele			

26.1 Përfaqesues i Punëmarrësve	Po
26.2 Kushtet e pjesëmarrjes	
27. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.	
28. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës (plotësohet nëse është Sh.a me dy nivele)	Elvis Preçi
28.1 Kryetar/anëtar	Anëtar
28.2 Afati i emërimit	Nga : 05/04/2023 Deri : 05/04/2026
29. Anëtar i Pavarur	Po
29.1 Përfaqesues i Punëmarrësve	Po
29.2 Kushtet e pjesëmarrjes	
30. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.	
31. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës (plotësohet nëse është Sh.a me dy nivele)	Morena Mehmetaj
31.1 Kryetar/anëtar	Anëtar
31.2 Afati i emërimit	Nga : 05/04/2023 Deri : 05/04/2026
32. Anëtar i Pavarur	Po
32.1 Përfaqesues i Punëmarrësve	Po
32.2 Kushtet e pjesëmarrjes	
33. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.	
34. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës (plotësohet nëse është Sh.a me dy nivele)	Altin Rrukaj
34.1 Kryetar/anëtar	Anëtar
34.2 Afati i emërimit	Nga : 05/04/2023 Deri : 05/04/2026
35. Anëtar i Pavarur	Po
35.1 Përfaqesues i Punëmarrësve	Po
35.2 Kushtet e pjesëmarrjes	
36. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.	
37. Eksperti/ët Kontabël i Autorizuar	Drita Baku
37.1 Afati i emërimit	Nga : 05/04/2023 Deri :
38. Aksionarët	Bashkia Shkoder
38.1 Numri i Aksioneve	Me te drejte vote : 140530.0000 Pa te drejte vote :
38.2 Përqindja e pjesëmarrjes	36,33
39. Aksionarët	Ministria e Infraskturës dhe Energjitikës

Akti i ekspertit të pavarur të emeluar nga gjykata për vlerësimin e kontributit në natyrë
Mandati bankar për shlyerjen e kontributit në para (nëse kontributi është në para)

Regjistrimi Fillestar: CN-101109-04-23

HISTORIKU I REGJISTRIMIT


Data e regjistrimit	Ndryshimi i te dhenave të regjistruara
12/07/2023	<p>Numri i ceshjes: CN-155320-07-23</p> <p><u>Vlera e Kapitalit ishte</u> "10.000.000,00" u be "38.680.000,00"</p> <p><u>Numri i Aksioneve ishte</u> "100.000,00" u be "386.800,00"</p> <p><u>Capital Paid Value ishte</u> "5.100.000,00" u be "12.600.000,00"</p> <p><u>Kane ndodhur ndryshimet e mëposhtme tek ortaket juridik:</u></p> <p><u>është shtuar ortaku:</u> ("Bashkia Shkoder") Numri i aksioneve <u>"140.530,00"</u> Perqindja ne kapital "36,33" Kontributi ne para <u>"14.053.000,00"</u></p> <p><u>Kane ndryshuar te dhenat per</u> ("Bashkia Vau i Dejes") , Përqindja e <u>Kapitalit ishte</u> ("12,48") u be ("3,23")</p> <p><u>Kane ndryshuar te dhenat per</u> ("Bashkia Malesi e Madhe") , <u>Përqindja e Kapitalit ishte</u> ("24,70") u be ("6,39")</p> <p><u>Kane ndryshuar te dhenat per</u> ("Bashkia Puke") , Përqindja e <u>Kapitalit ishte</u> ("8,49") u be ("2,19")</p> <p><u>Kane ndryshuar te dhenat per</u> ("Bashkia Puke") , Numri i aksioneve <u>ishte</u> ("84.900,00") u be ("8.490,00")</p> <p><u>Kane ndryshuar te dhenat per</u> ("Bashkia Fushë Arrëz") , Përqindja e <u>Kapitalit ishte</u> ("3,33") u be (",86")</p> <p><u>Kane ndryshuar te dhenat per</u> ("Ministria e Infraskturës dhe Energjitikës") <u>, Vlera e Kontributit ishte</u> ("5.100.000,00") u be <u>("19.727.000,00")</u></p> <p><u>Kane ndryshuar te dhenat per</u> ("Ministria e Infraskturës dhe Energjitikës") <u>, Numri i aksioneve ishte</u> ("51.000,00") u be ("197.270,00")</p> <p>Lista e Dokumenteve: Vendim i asamblese se pergjithshme</p>

Datë :18/10/2023

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

GEN - PLAN

SH 1: 500



Zona Kadastrale 8594
Indeksi i hartes SH. N-8
Nr. Pasurise 4/49

SKEMA E VENDOSJES SH. 1:2000



POZICIONI KADASTRAL SH. 1



